

KOMUNA E STRUGËS



**STRATEGJIA PËR
MBROJTJE SOCIALE
TË QYTETARËVE
2015-2020**

STRATEGJIA
SOCIALE
TË QYTETARËVE
2015-2020

KOMUNA E STRUGËS



**STRATEGJIA E
KOMUNËS SË STRUGËS PËR
MBROJTJE SOCIALE TË
QYTETARËVE
2015-2020**

Impressum

Botues:

Komuna e Strugës

Për botuesin:

Ziadin Sela, Kryetar i Komunës

Përktheu në gjuhën shqipe:

Ismail Krifca

Lekturoi dhe korrigjoi tekstin:

Luljeta Ademi

Grafika dhe dizajni:

Brigada dizajn

Shtypi:

Propoint

Tirazhi:

500 kopje

Tirazh falas / jo komercial

CIP - Каталогизација во публикација
Nационална и univerzitetaska biblioteka „Св. Климент Охридски“, Скопје

352.08:364.2(497.772)“2015/2020“

СТАРТЕГИЈА за социјална заштита на граѓаните на Општина Струга :
2015-2020. - Струга : Општина Струга, 2015. - 38 стр. ; 20 см

Насл. стр. на припечатениот текст: Strategjia për mbrojtje sociale
të qytetarëve : 2015-2020. - Обата текста меѓусебно печатени во
спротивни насоки. - Текст на мак. и алб. јазик. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-65849-3-1

а) Локална самоуправа - Социјална политика - Стратегии - Струга -
2015-2020 б) Струга - Социјална заштита - Стратегии за развој - 2015-2020
COBISS.MK-ID 98746122



FOUNDATION ФОНДАЦИЈА
OPEN ОТВОРЕНО
SOCIETY ОДШТЕСТВО
MACEDONIA МАКЕДОНИЈА

**Përgatitja e Strategjisë është
mbështetur financiarisht nga
Fondacioni Shoqëria e Hapur-Maqedoni.**

1. Përmbledhje ekzekutive	7
2. Hyrje	9
3. Vizioni	12
4. Parimet dhe vlerat	13
5. Politika aktuale për Mbrojtje sociale në Komunën e Strugës	15
6. Harta strategjike	19
7. Prioritetet dhe masat strategjike për Mbrojtje sociale deri në vitin 2020	21
7.1 Menaxhim me buxhetin.....	21
7.2 Zhvillimin e kapaciteteve.....	22
7.3 Sigurimin e shërbimeve.....	24
7.4 Qytetarë të kënaqur.....	25
8. Harta e balancuar e treguesve në Komunën e Strugës për sferën e Mbrojtjes Sociale	27
9. Monitorimi dhe vlerësimi	32

Lista e shkurtesave

- BPV**..... Bruto prodhimi vendor
- SC**..... Sektori civil
- KE**..... Komisioni Evropian
- NJVL**..... Njësia e vetëqeverisjes lokale
- BE**..... Bashkimi Evropian
- HBT**..... Harta e balancuar e treguesve
- TIK**..... Teknologjitë informative-komunikuese
- APEST**..... Analiza politiko-legjislative, ekonomike, sociale dhe teknologjike
- RM**..... Republika e Maqedonisë
- SWOT**..... Analiza e anëve të fuqishme dhe të dobëta, mundësitë dhe kërcënimet
- MS**..... Mbrojtja sociale
- FSHHM**..... Fondacioni Shoqëria e Hapur Maqedoni

Në këtë dokument strategjik shfrytëzohen terme dhe shprehje të cilat varësisht nga përdorimi i tyre i përditshëm në sektorë të ndryshëm të shoqërisë, mund të çojnë te perceptimi ndryshe i tyre. Për arsye të të kuptuarit dhe ndarjes së qartë të shprehjeve të përdorura, duhet të kemi parasysh sqarimet në vijim:

- 1. Mbrojtja sociale** – Sipas Ligjit për Mbrojtje Sociale (2009), në Republikën e Maqedonisë me termin “mbrojtje sociale” nënkuptojmë sistem të masave, aktiviteteve dhe politikave për pengimin dhe tejkalimin e rreziqeve sociale themelore mbi të cilat është ekspozuar qytetari gjatë jetës së tij, si edhe masat, aktivitetet dhe politikat për uljen e varfërisë dhe përjashtimit social dhe për forcimin e kapacitetit të qytetarit për mbrojtje personale.
- 2. Parandalimi Social** – është përmbledhje e masave dhe aktiviteteve me të cilat pengohet krijimi i rreziqeve sociale, bëhet zbulimi i hershëm dhe trajtim i hershëm i qytetarit i cili është i ekspozuar rrezikut social, me qëllim të tejkalimit ose zbutjes së pasojave të dëmshme nga ekspozimi në rrezikun social.
- 3. Mbrojtja institucionale** – përfshin të drejtën për aftësim për aktivitete punuese-produktive dhe të drejtën për akomodim në ente për mbrojtje sociale.
- 4. Mbrojtja jashtë institucionale** – që realizohet në ose nëpërmjet qendrës për punë sociale që përfshin të drejtën për: shërbimin e parë social për shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale; ndihma për individin; ndihmë familjes; kujdesin shtëpiak dhe ndihmë individit dhe familjes; akomodim ditor dhe të përkohshëm dhe kujdes, si ndihmë ndaj individit dhe familjes; akomodim në familje kujdestare; akomodim në shtëpi të vogël grupore dhe banim i pavarur me mbështetje.
- 5. Shërbime sociale lokale** – janë shërbime për mbrojtje dhe parandalim social që ofron njësia e vetëqeverisjes lokale, në teritorrin e saj, në pajtueshmëri me ligjin.

Sqarime terminologjike

6. **Komuna** – njësi e vetëqeverisjes lokale, si bashkësi e banorëve në një rajon të caktuar, të vërtetuar me ligj, e cila nëpërmjet organeve të veta dhe nëpërmjet administratës dhe shërbimeve të organizuara publike, mundëson kryerjen e kompetencës së paraparë me ligj.
7. **Kompetenca** – përmbledhje të çështjeve me interes publik të rëndësishme lokale të cilat komuna në pajtueshmëri me ligjin, ka të drejtë që t'i kryejë në rajonin e vet dhe është përgjegjëse për realizimin e tyre.
8. **Qytetarët e synuar** – grupet e synuara të qytetarëve në nevojë për lloje të caktuara të mbrojtjes sociale.
9. **Shoqatat e qytetarëve** – organizata të regjistruara në përputhje me Ligjin për shoqata dhe fondacione.
10. **Harta strategjike** (nga gjuha angleze Strategic Map) – strukturë logjike e cila tregon lidhshmëri logjike shkak-pasojë mes qëllimeve prioritare strategjike.
11. **Harta e balancuar e treguesve HBT** (nga gjuha angleze Balance Score Card) është sistem i planifikimit dhe menaxhimit strategjik i cili shfrytëzohet në biznes, sektorin publik dhe organizatave joprofitabile.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Komuna e Strugës filloi një proces të Planifikimit Strategjik me të cilin i identifikoi nevojat e tanishme dhe të ardhshme të bashkësisë dhe në bazë të kësaj përcaktoi vizionin e saj, vlerat, qëllimet dhe strategjitë me të cilat do t'u përgjigjet në përbushjen e këtyre nevojave. Rezultat i këtij procesi kompleks është Strategjia e Komunës së Strugës për mbrojtje sociale të qytetarëve të vet, që përfshin periudhën e viteve 2015-2020. Strategjia në vete përmban vizion të përcaktuar për zhvillim të mbrojtjes sociale në komunën e Strugës, parime udhëheqëse për implementimin e strategjisë, si edhe prioritetet dhe masat strategjike për arritjen e vizionit të projektuar. E gjithë strategjia është formuar në mënyrë të tillë që në vete bashkon katër pikëpamje të ndryshme dhe pozitiva fillestare, së bashku me të gjitha lidhjet dhe korrelacionet midis tyre, duke u lidhur me vizionin e komunës. Ato janë perspektivat e: qytetarëve të kënaqur (çfarë presin qytetarët nga komuna), sigurimit të shërbimeve (cilat procese të brendshme duhet të përfshihen), zhvillimit të kapaciteteve (mësimi i të punësuarve dhe rritja organizative) dhe menaxhimit me buxhetin (si të financohen aktivitetet).

Të gjitha elementet e strategjisë janë të bashkuara dhe të sistematizuara në Hartën e Balancuar të Treguesve (HBT)¹, dokument i cili i siguron qëllimet prioritare, treguesit kryesorë për arritjen e tyre, qëllimet e vlerave të cilat dëshirohen të arrihen si edhe masat dhe iniciativat të cilat duhet të sigurojnë arritjen e tyre. Ndjekja konsistente dhe realizimi i masave dhe iniciativave të përmbytura në dokumentin nga ana e Kryetarit të Komunës, administratës komunale dhe Këshillit të Komunës, si edhe mbështetja e duhur financiare do të sigurojnë arritjen e vizionit dhe besimit në përkushtimin, transparencën dhe efikasitetin e komunës së Strugës për mbrojtje sociale të qytetarëve të vet. Vizioni i komunës së Strugës për mbrojtje sociale të qytetarëve të saj 2015-2020:

¹ Kaplan, R. and Norton, D., The Balanced Scorecard, Measures that Drive Performance, Harvard Business Review (1992)



“Grupet e rrezikuara të qytetarëve janë përfshirë në jetën e gjithmbarshme të komunës përmes institucioneve të organizuara për mbështetjen e tyre dhe sigurimin e kushteve për ekzistencën e pavarur materiale”

Prioritetet strategjike të komunës për secilën nga perspektivat janë:

■ QYTETARËT E KËNAQUR:

- **QK1** Qytetarët pranojnë mbrojtje sociale në mënyrë të lehtë, efikase dhe transparente përmes rritjes së vëllimit të shërbimeve

■ SIGURIMI I SHËRBIMEVE:

- **SSH1** Sektor kompakt, funksional dhe i integruar për mbrojtje sociale
- **SSH2** Partneritete të suksesshme me publikun, sektorin privat dhe civil
- **SSH3** Shpërndarje institucionale dhe jashtë institucionale e shërbimeve

■ ZHVILLIMI I KAPACITETEVE:

- **ZhK1** Përmirësimi i sistemit për zhvillimin e resurseve njerëzore për përfitimin e aftësive,
- **ZhK2** Kapacitete dhe resurse për zbatimin me sukses të aktiviteteve
- **ZhK3** Futja e sistemit vullnetar (shërbim) është kapaciteti plotësues në zbatimin e kompetencës

■ MENAXHIM ME BUXHETIN:

- **MB1** Arritja e një vëllimi të lartë të burimeve të jashtme, plotësuese të mjeteve financiare për mbrojtje sociale
- **MB2** Arritja e konsistencës të shumës së fondeve buxhetore për mbrojtjen sociale
- **MB3** Rritja e investimeve për mbrojtje sociale

Strategjia për Mbrojtjen Sociale për periudhën 2015 - 2020 është miratuar nga Këshilli i Komunës së Strugës në shkurt 2015.

HYRJE

Mbrojtja sociale është veprimtari me interes publik e një rëndësie të veçantë për qytetarët e Republikës së Maqedonisë sepse me të përcaktohet sistemi i politikave, masave dhe aktiviteteve me të cilat duhet të pengohen dhe tejkalohen rreziqet themelore sociale në të cilat është i ekspozuar qytetari gjatë jetës së tij, të ulet varfëria dhe përjashtimi social në vend dhe të forcohet kapaciteti i qytetarit për mbrojtje personale. Ky sistem realizohet nëpërmjet punës profesionale të enteve për mbrojtje sociale, zbatimit të programeve zhvillimore, aftësim profesional i punëtorëve, monitorimit të dukurive dhe planifikimit të punës, udhëheqjen e evidencës, zbatimin e mbikqyrjes si edhe punë hulumtuese në këtë sferë. Përkaj masave për mbrojtje sociale të qytetarit, kujdesi i shtetit për pengimin e krijimit të rrezikut social realizohet edhe përmes ndërmarrjes së masave në politikën tatimore, punësim, politikën e stipendimit, banimit, mbrojtjes së familjes, shëndetësisë, edukim dhe arsim si edhe në fusha të tjera.

Bartësit e mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë janë pushteti qendror nëpërmjet Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale dhe njësisë për vetëqeverisjes lokale. Edhe pse mbrojtja sociale si kompetencë është e decentralizuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të vitit 2002 (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 5/2002,2002), e pastaj edhe Ligjin për Mbrojtje Sociale të vitit 2009 (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.79/09,2009), në Republikën e Maqedonisë shumë pak komuna morën guximin që me seriozitet t'i përkushtohen kësaj çështje të rëndësishme. Komuna e Strugës, si një subjekt serioz publik, i përgjegjshëm drejt përpjekjes që të jetë me qytetarët e vet edhe në kohë të krizës ekonomike dhe financiare e cila sundon edhe në nivel kombëtar edhe në ndërkombëtar, vendosi që mbrojtjen sociale ta përfshijë mes fushave prioritare strategjike mbi të cilat do t'i përkushtohet në periudhën e viteve 2015-2020.

Rezultati i përpjekjes është ky dokument “Strategjia e Komunës së Strugës për Mbrojtje Sociale të Qytetarëve të Saj” e cila ka të bëjë me ndërtimin e vizionit, prioritetëve dhe masave për mbrojtje të banorëve lokal nga rreziqet sociale përmes ofrimit të shërbimeve komunale në institucionet komunale edhe atë përmes vendosjes së partneriteteve me palët tjerë të interesuar nga sektori publik, privat dhe civil.

Në procesin e përpunimit të kësaj strategjie ishte siguruar qasje gjithpërfshirëse dhe pjesëmarrje aktive të anëtarëve të Këshillit dhe administratës komunale. Në të vërtetë, procesi paraprakisht ishte mbështetur me një sërë trajnimesh për: (1) përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale, (trajnim për planifikim strategjik me shfrytëzimin e Hartës Balancuese të Treguesve, krijimi i politikave pjesëmarrëse, financimi nga fondet e BE-së dhe strategji të komunikimit); (2) organizatat civile, (trajnim për njohuri më të mira mbi kompetencat e komunave, Fondet e BE-së dhe politikat për antidiskriminim), dhe (3) shkollat, (trajnim për menaxhim demokratik, drejtësi sociale dhe zhvillim i planeve shkollore). Procesit të planifikimit strategjik i paraprinte hartimi i analizës gjithpërfshirëse të gjendjes aktuale në komunë, e cila u realizua nëpërmjet pyetësorëve dhe anketave me të gjitha palët e interesuara nga administrata komunale dhe përfaqësuesve të SHQ, si edhe analiza e dokumentave ekzistuese relevante². Në procesin e hartimit të Strategjisë u morën parasysh të gjitha dokumentet strategjike mbi politikat për mbrojtjen sociale në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Procesit vazhdoi me organizimin e tri debateve publike me qëllim të sigurimit të një debati të hapur dhe harmonizimit të politikave dhe prioritetëve dhe masave të propozuara strategjike, si edhe të rritet ndjenja e përfundimit të lidhur me përpilimin e strategjisë dhe rritjes së përqendrimit dhe përgjegjësisë të implementimit të saj. Planifikimi strategjik bazohej mbi shfrytëzimin e modelit të Hartës së Balancuar të Treguesve dhe përbëhej nga:

- Trajnim për palët e interesuara;

² Raport mbi gjendjen aktuale në Komunën e Strugës (arsim, socialë, mbrojtje sociale dhe bashkëpunim me sektorin civil), FSHM, maj 2013

- Analizë gjithpërfshirëse të gjendjes aktuale në komunë në sferën sociale;
- Hulumtim në terren mbi kënaqësisë e qytetarëve nga shërbimet lokale në komunë;
- Analizë e palëve të interesuara;
- PEST-Analiza;
- SWOT/TOWS-Analiza;
- Formulim i vizionit;
- Identifikimi i parimeve dhe vlerave;
- Përcaktimin e qëllimeve prioritare të strategjisë;
- Përpilimi i Hartës Strategjike;
- Definimi i treguesve kryesor të realizimit;
- Përcaktimin e vlerave të qëllimit për secilin tregues kryesor të realizimit;
- Identifikimin e masave dhe aktiviteteve për arritjen e vlerave të qëllimit;
- Përpilimin e Hartës së Balancuar të Treguesve;
- Hartimin e projekt vizionit të strategjisë;
- Debati publik dhe
- Miratimi i Strategjisë nga ana e Këshillit të Komunës së Strugës.

Strategjia do të shoqërohet me planin e veprimit, i cili do të përpilojë aktivitetet konkrete dhe do të kontribuojë në përmbushjen e masave dhe iniciativave të përcaktuara në drejtim të arritjes së vizionit të komunës.



Detyrimi Ligjor është që kjo Strategji t'i lëshohet Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale për shqyrtim, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11 të Ligjit për Mbrotjtje Sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.79/09,2009).

VIZIONI

Vizioni i komunës së Strugës për zhvillim të mbrojtjes sociale deri në vitin 2020 është:



Grupet e rrezikuara të qytetarëve janë përfshirë në jetën e gjithmbarshme të komunës nëpërmjet institucioneve të organizuara për mbështetjen e tyre dhe kushteve të siguruarra për ekzistencë të pavarur materiale.

Ky vizion do të realizohet nëpërmjet përmbushjes së nevojave të qytetarëve për gëzimin e mbrojtjes sociale në mënyrë të lehtë, efikase dhe transparente, përmes rritjes së vëllimit të shërbimeve. Faktori kryesor për realizimin e këtij vizioni do të jetë Sektori për Mbrojtje Sociale i Komunës së Strugës. Për një realizim ekonomik, efikas dhe efektiv të këtij funksioni, Sektori do të jetë kompakt, funksional dhe pjesë e integruar e administratës komunale dhe aktivitetet do t'i implementojë nëpërmjet krijimit të partneriteteve me sektorin publik, privat dhe civil për krijimin e përmbushjeve institucionale dhe jashtëinstitucional të shërbimeve. Të punësuarit në Sektorin për Mbrojtje Sociale duhet të kenë aftësi, kapacitet dhe resurse për zbatim të suksesshëm të aktiviteteve, e si pjesë plotësuese do të jetë edhe përfshirja e Sistemit të Vullnetarëve (shërbim) si kapacitet plotësues në zbatimin e kompetencave. Për realizim të këtij vizioni, është e nevojshme edhe angazhimi i vëllimit të lartë të burimeve të jashtme të mjeteve financiare për mbrojtjes sociale edhe konzistencë e mjeteve buxhetore të komunës për mbrojtje sociale, si edhe rezervimin e mjeteve për rritje të investimeve në fushën e mbrojtjes sociale.

PARIME DHE VLERAT

Në procesin e realizimit të prioriteteve dhe masave strategjike për realizimin e vizionit të Komunës së Strugës për bashkëpunim me mbrojtje sociale në periudhën 2015-2020 do të respektohen parimet dhe vlerat në vijim:

- **Barazi:** në implementimin e strategjisë ka raport të barabartë ndaj të gjithë qytetarët pa dallim të përkatësisë së tyre etnike, fetare, gjinore, moshës ose përkatësie tjetër sociale.
- **Prioriteti i grupeve më të rrezikuara:** në ofertën dhe shpërndarjen e shërbimeve përparësi do t'i jepet grupeve të të rrezikuara të qytetarëve.
- **Përfshirje:** qytetarët do të përfshihen në sistemin e mbrojtjes me të gjitha të drejtat, resurset e mundshme të cilat i kemi në dispozicion.
- **Profesionalizëm:** aktivitetet do të zbatohen duke punuar në mënyrë objektive dhe duke ndjekur procedurat e parapara.
- **Risi:** vazhdimisht do të kërkohen veprime spontane dhe sistematike për përfshirjen e mënyrave të reja për kryerjen më të mire të punës.
- **Ligjshmëria:** gjatë realizimit të të gjitha aktiviteteve të parapara me strategjinë do të respektohen ligjet e Republikës së Maqedonisë.
- **Etikë:** në përmbushjen e qëllimeve do të niset prej parimit të Kodit Etik të Nëpunësve Shtetërorë të RM-së.
- **Përcaktim për dialog sociale:** si do të ndihmojë komuna ndërveprimin midis sindikatave lokale dhe punëdhënësve, si edhe palëve të tjera të interesuara.

- **Partneriteti i komunës me institucionet publike, sektorin e biznesit dhe atij civil:** në implementimin e prioriteteve strategjike do të ndërtohen partneritete dhe do të përfshijmë kapacitetet e institucioneve të tjera publike, organizatave nga sektori civil dhe atij biznesor.
- **Transparencë:** do të promovohet niveli më i lartë publik mbi informacionet me të cilat disponon, shërbimet të cilat ofrohen, procedurat sipas të cilave realizohet dhe kriteret sipas të cilave jepen.

POLITIKAT AKTUALE PËR MBROJTJE SOCIALE NË KOMUNËN E STRUGËS

Zbatimi i Mbrojtjes Sociale si kompetencë e pushtetit lokal është rregulluar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale në vitin 2002 (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 5/2002,2002), dhe Ligjin për Mbrojtje Sociale të vitit 2009 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.79/09,2009) dhe ndryshimet e tij nga viti 2011,2012,2013 dhe 2014. Njësitë e vetëqeverisjes lokale janë një nga bartësit e mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë së bashku me Ministrinë për Punë dhe Politikë Sociale si përfaqësues i pushtetit qendror.

Sipas nenit 11 të Ligjit për Mbrojtje Sociale grupet e qytetarëve të rrezikuar për të cilët komuna duhet të sigurojë gëzimin e mbrojtjes sociale janë: personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa prindër dhe fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët me pengesa në zhvillimin mental dhe fizik, fëmijët në rrugë, fëmijët me probleme edukative-sociale, fëmijët nga familjet me një prindër, personat të ekspozuar ndaj rrezikut social, personat të cilët përdorin drogë, substanca të tjera psikotropike, prekursorëve dhe alkool, personat viktimë të dhunës në familje, personat viktimë të trafikimit me njerëz dhe personat e moshuar pa kujdes familjar.

Ligji parasheh që mbrojtja të bëhet nëpërmjet formave jashtë institucionale dhe institucionale të mbrojtjes sociale, strehim dhe ngritje të vetëdijes të popullatës për nevojat e sigurimit të mbrojtjes sociale. Sipas këtij ligji (neni 12), lejohet që komuna me vendim të vetin, e në pajtueshmëri me mundësitë materiale, të parashikojë edhe të drejta të tjera në sferën e mbrojtjes sociale, të drejta në vëllim më të madh se ato të parapara ose të sigurojë kushte të volitshme për realizimin e tyre. Komuna ka të drejtë të krijojë edhe forma të tjera të mbrojtjes sociale.

Mbi bazë të kësaj kornize ligjore, ofrimi real i këtyre shërbimeve nga ana e komunës së Strugës për shfrytëzuesit e vet zhvillohet në mënyrën në vijim:

- Ofrimi i plotë i shërbimeve sigurohet për:
 - Shërbime për fëmijët me pengesa në zhvillimin mental dhe fizik dhe
 - Kopshtet e fëmijëve
- Ofrim i pjesshëm i shërbimeve sigurohet për:
 - Mbrojtje sociale për personat me aftësi të kufizuara
 - Fëmijët pa prindër dhe fëmijët pa kujdes prindëror
 - Fëmijët nga familjet me një prindër
 - Personat e ekspozuar rrezikut social
 - Ngritja e vetëdijes së popullatës mbi nevojat për sigurimin e mbrojtjes sociale
 - Shërbime të tjera – në nivel të rastësishëm dhe mbi bazë të kërkesave dhe rasteve individuale
 - Antidiskriminimi
- Nuk sigurohen shërbime për:
 - Fëmijët në rrugë
 - Personat që përdorin drogën, substance të tjera psikotropike, prekursorë dhe alkool
 - Persona viktimë të dhunës në familje
 - Personat viktimë të trafikimit me njerëz
 - Personat e moshuar pa kujdes familjar

Në aspektin programor, Komuna e Strugës aktivitetet e veta aktuale tek kompetenca mbi Mbrojtjen Sociale i bazon tek dokumentet e përgjithshme strategjike ose politikave afatshkurtra të Këshillit dhe të Kryetarit të komunës. Prezentë janë edhe aktivitetet e kohëpaskohshme në bashkëpunim me agjencitë e huaja zhvillimore ose pushtetin qendror. Komuna për here të parë hartoi Programin për Mbrojtje Sociale për vitin 2014. I njëjti është përpiluar në Tetor të vitit 2013 dhe është miratuar nga ana e Këshillit. Ky program është harmonizuar me Programin Kombëtar për mbrojtje sociale dhe është dhënë për aprovim në MPPS. Ministria ka lëshuar mendim pozitiv për Programin. Më shumë se 40% e aktiviteteve në program kanë të bëjnë me aktivitetet mbi parandalimin social, mbrojtjes jashtë institucionale dhe mbrojtjes institucionale.

Nga aspekti i pozicionimit organizativ për zbatimin e kompetencës, deri në fund të vitit 2013 në Komunë është krijuar sektori për mbrojtje sociale ku është deleguar realizimi i aktiviteteve të nevojshme për zbatimin e politikave dhe shërbimeve komunale nga kjo lëmi. Sektori përbëhet nga Njësia për Mbrojtjen Sociale me 2 të punësuar: udhëheqës i njësisë dhe referenti. Sektori udhëhiqet nga udhëheqësi. Të gjithë të punësuarit janë me orar të plotë pune dhe kanë minimum një vit përvojë pune në këtë pozitë. Komuna akoma nuk posedon regjistër të shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale, por në vijim është bashkëpunimi i përbashkët me Qendrën për Punë Sociale (QPS) për të identifikuar dhe shënuar shfrytëzuesit e ndihmave sociale.

Në komunë akoma nuk ekzistojnë mekanizma të drejtpërdrejtë dhe procedura të vërtetuara administrative për sigurimin e shërbimeve për mbrojtje sociale, ndërsa sektori I ndërton kapacitetet e veta. Ekziston vetëm një praktikë pjesërisht e krijuar në informimin e qytetarëve mbi aktivitetet në fushën e mbrojtjes sociale. Më së shpeshti një informacion i këtillë shpallet në tabelën e shpalljeve të komunës dhe internet faqen e komunës.

Gjithsesi, mbrojtja sociale si veprimtari dhe kompetencë nuk është e izoluar nga zhvillimet dhe proceset tjera shoqërore dhe

mbi të ndikojnë edhe faktorët dhe gjendjet e jashtme, e para së gjithash ato ekonomik-social: kriza ekonomike disa vjeçare, rritja minimale e BPV-së, papunësia, shpërngulja e popullatës etj. Edhe pse projektimet ekonomike të Qeverisë në buxhetin e RM-së janë pozitive dhe shfaqin shpresë për përmirësimin e gjendjes aktuale, realizimi i këtyre në jetën e përditshme në Komunën e Strugës akoma nuk ka dhënë lëvizje konkrete pozitive. Edhe rajoni planifikues në të cilin bën pjesë komuna, ai iugperëndimor, ka tregues ekonomi nën mesataren në raport me rajonet e tjera. Nga ana tjetër, Komuna e Strugës është bashkësi multikulturore dhe multietnike me traditë të bashkëjetesës dhe ndihmë të bashkëqytetarëve që paraqet një bazë të mirë për zhvillim të aktiviteteve nga mbrojtja sociale. Sektori civil është shumë i zhvilluar dhe paraqet mundësi të madhe për qasje të reja drejt mbrojtjes. Në Strugë si vlerë kulturore midis qytetarëve është kultivimi i familjes tradicionale dhe mbrojtja e të moshuarve dhe fëmijëve në suazat e familjes, që duhet të mbështetet nga ana e pushtetit lokal, në veçanti në pjesët rurale të komunës.

HARTA STRATEGJIKE

Harta strategjike jep pasqyrë të plotë të lidhshmërisë shkaktuese të prioriteteve në Komunën e Strugës në arritjen e Vizionit për Mbrojtje Sociale deri në vitin 2020, nëpërmjet katër perspektivave:

- Qytetarë të kënaqur,
- Sigurimi i shërbimeve,
- Forcimi i kapaciteteve dhe
- Menaxhimi me buxhetin

Mbi bazë të analizave gjithpërfshirëse të secilës prej perspektivave (Shtojca) janë definuar qëllimet prioritare strategjike (strategjitë) për secilë perspektivë veçmas.

HARTA STRATEGJIKE E KOMUNËS SË STRUGËS PËR MBROJTJE SOCIALE 2015-2020

VIZIONI:

„GRUPET E RREZIKUARA TË QYTETARËVE JANË PËRFSHIRË NË JETËN E PËRDITSHME TË KOMUNËS PËRMES INSTITUCIONEVE TË ORGANIZUARA PËR MBËSHTETJEN E TYRE DHE KUSHTEVE TË SIGURUARA PËR EKZISTENCË TË PAVARUR MATERIALE“

QYTETARË TË KËNAQUR:

Mbrojtje sociale në mënyrë të lehtë, efikase dhe transparente përmes vëllimit të rritur të shërbimeve

SIGURIMI I SHËRBIMEVE:

Sektor kompakt, funksional dhe integruar

Partneritet i suksesshëm me sektorin publik, privat dhe civil

Distribuum institucional dhe jashtinstitucional i shërbimeve

NDËRTIMI I KAPACITETEVE:

Të punësuarit kanë aftësi, kapacitet dhe resurse për zbatim të suksesshëm të aktiviteteve

Sistemi i vullnetarëve është kapacitet plotësues në zbatimin e kompetencës

MENAXHIMI ME AFATIN:

Vëllim i lartë i burimeve të jashtme të mjeteve për MS

Qëndrueshmëri e mjeteve buxhetore për MS.

Investime të zmadhuara për MS

PARIMET/VLERAT:

INOACION, PROFESIONALIZËM, PRIORITET TË GRUPEVE TË RREZIKUARA, LIGJSHMËRI, ETIKË, PARTNERITET I KOMUNËS ME INSTITUCIONET PUBLIKE, OJQ-TË DHE SEKTORIN E BIZNESIT, BARAZI - TRAJTIM I BARABARTË MULTIETNIK DHE FETAR, PËRFSHIRJE, TRANSPARENÇË

PRIORITETET DHE MASAT STRATEGJIKE PËR MBROJTJE SOCIALE DERI NË VITIN 2020

7.1 Menaxhimi me buxhetin

Në bazë të vlerësimit të bërë mbi gjendjen aktuale, analizës së situatës, përfshirë edhe (SWOT) prioritetizimin e ideve, si prioritete strategjike të komunës së Strugës tek kompetenca mbrojtje sociale, nga perspektiva e menaxhimit me buxhetin janë zgjedhur, si vijon:

- **MB1:** Sigurimi i vëllimit të lartë të burimeve të jashtme, plotësuese të mjeteve financiare për mbrojtje sociale

Ky prioritet do të arrihet nëpërmjet marrjes së masave si: Krijimi i sistemit/politikave për kofinancim të projekteve dhe aktiviteteve me biznes sektorin dhe sektorin joqeveritar (PPP), Shfrytëzimin e fondeve të BE-së si edhe Krijimin e politikës tatimore stimuluese lokale për partneritetet dhe aktivitetet në mbrojtjen sociale. Me realizimin e këtij prioriteti do të shfrytëzoheshin mundësitë e identifikuar për ekzistimin e vullnetit dhe mjeteve për përfshirjen e sektorit të biznesit nga ana e komunës dhe do të zvogëloheshin kërcënimet të cilat vijnë nga mungesa e bllok-dotacioneve për mbrojtje sociale të cilat i merr komuna. Ana e fuqishme tregon se forma e ekipit të ri në kornizat e Sektorit për Mbrojtje Sociale mund ta realizojë këtë detyrë po gjithsesi për këtë janë të nevojshme mjete dhe aktivitete të duhura të përshkruara në perspektivën Zhvillim i kapaciteteve.

- **MB2:** Arritjen e konsistencës në mjetet buxhetore për mbrojtje sociale

Ky prioritet doli nga ana e fuqishme e komunës për financimin e mbrojtjes sociale nga mjetet personale por edhe ana e dobët se një pjesë e madhe prej aktiviteteve për mbrojtje sociale janë përfshirë me programe të tjera buxhetore që mund të sjellë deri tek destabi-

liteti për mjetet e rezervuara për socialen dhe deri tek rrezikshmëria e prioritetëve tjerë të kësaj strategjie. Për shkak të këtyre, propozohet masa – Hartimi i Metodologjisë për shpërndarje të brendshme të buxhetit komunal, në veçanti për programin për mbrojtje sociale. Realizimi i këtij prioriteti do të reflektohet pozitivisht tek të gjitha prioritetet dhe masat e tjera strategjike dhe do të ofrojë mbështetje: që ekipi të ketë mjete për të realizuar rezultate, të realizohen aktivitetet praktike dhe konkrete, të sigurojë stabilitet në planifikimin e aktivitetëve.

- **MB3:** Rritja e investimeve për mbrojtjen sociale

Realizimi i vizionit komunal për mbrojtje sociale, (në veçanti në pjesën për institucionet), mund të realizohet në mënyrë solide vetëm nëse ndërmerren së paku investime minimale në mbrojtjen sociale. Por që të arrihet deri tek ky prioritet është e nevojshme që në kohë të Përcaktohen projektet nga sfera e mbrojtjes sociale në pjesën zhvillimore të buxhetit, Dizajnohen projekt-ide për tërheqjen e financave dhe Aplikimi i thirrjeve publike për grante për financimin e projekteve investuese.

7.2 Zhvillimi i kapaciteteve

Në perspektivën e Zhvillimit të Kapaciteteve është e nevojshme që të zhvillohen strategji të cilat do të aftësojnë dhe inkurajojnë të punësuarit në administratën komunale që të luftojnë dhe të punojnë mbi realizimin e vizionit të komunës tek kompetenca e mbrojtjes sociale. Në këtë drejtim, e mbi bazë të të gjitha analizave dhe prioritetëve paraprake janë përcaktuar prioritetet strategjike dhe masat e duhura për implementim edhe atë si vijon:

- **ZhK1:** Përmirësimi i sistemit për zhvillimin e resurseve njerëzore për përfitimin e aftësive, kapaciteteve dhe resurseve për zbatimin me sukses të aktivitetëve

Ky prioritet është i një rëndësie të madhe për implementimin e gjithë strategjisë sepse në të janë përmbajtur strategjitë për forcimin e kapaciteteve të të punësuarve nga Sektori për Mbrojtje Sociale. Që të realizohet, prioriteti së pari duhet të bëhet, e mbi atë bazë të bëhet vlerësim, plan dhe implementim për trajnim të rregullt dhe sistematik i të punësuarve nga sektori. Pastaj, masë shumë e rëndësishme për mbështetjen do të jetë krijimi i kulturës për bashkëpunim të brendshëm, ndërsektorial dhe ndërinstitucional (me orientim të brendshëm organizativ), si edhe kapaciteti për këmbim të dijeve dhe përvojave me partnerët dhe faktorët tjerë (me orientim të jashtëm organizativ). Në këtë mënyrë do të mund të realizohen edhe prioritetet strategjike të vendosura me perspektivën për Sigurimin e Shërbimeve – Sektor kompakt dhe efektiv dhe Realizimi i partneriteteve.

- **ZhK2:** Futja e sistemit vullnetar (shërbimeve) është kapacitetet plotësues në zbatimin e kompetencës

Ky prioritet është nxjerrë nga SWOT-analiza e bërë sektorit, e në veçanti duke u mbështetur tek mundësitë në mjedisin i cili sugjeron sektor aktiv civil dhe vetëdije të zhvilluar të faktorëve në sektorin e MS në territorin e komunës së Strugës, si edhe duke marrë parasysh se kapaciteti i të punësuarve në sektor nuk është i mjaftueshëm. Në këtë drejtim janë paraparë masat në vijim: planifikimi i rolit të sistemit vullnetar në zbatimin e mbrojtjes sociale në nivel lokal, krijimi i grupeve të vullnetarëve dhe trajnimi i tyre dhe implementimi i shërbimit vullnetar. Ky prioritet strategjik do të jetë i lidhur me prioritetet strategjike në perspektivën Sigurimi i shërbimeve dhe Qytetarë të kënaqur.

7.3 Sigurimi i shërbimeve

Në perspektivën e sigurimit të shërbimeve fokusimi bëhet tek proceset e brendshme të cilat duhet të jenë krijuar ose përforcuar që të mund të realizohet vizioni i komunës si edhe prioritetet strategjike të definuara në perspektivën e Zhvillimit të kapaciteteve dhe Qytetarëve të kënaqur. Kjo perspektivë është kryesore nga aspekti se çfarë duhet të bëjë ose të ndryshojë komuna si sistem dhe organizim të veprimit. Në këtë drejtim, nga analizat e bëra rezultuan prioritetet strategjike vijuese:

- **SSH1:** Ndërtimi i sektorit kompakt, funksional dhe i integruar për mbrojtje sociale

Gjatë përcaktimit të këtij prioriteti u mor parasysh ana e fuqishme e Sektorit të sapo krijuar, me të punësuar që kanë qasje bashkëkohore për kryerjen e punës. Që ata të mund të punojnë në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive, ata përveç aftësive dhe kapaciteteve (të përshkruara në perspektivën Zhvillim i Kapaciteteve) duhet të kenë edhe pozicionim solid organizativ, me përcaktim të qartë të proceseve dhe procedurave të brendshme, si edhe koordinim produktiv ndërsektorial. Me qëllim të realizimit të këtij prioriteti janë definuar masat vijuese: analiza e kompetencave dhe rrumbullaksimit të duhur të sistematizimit të vendeve të punës në sektor me përcaktimin e detyrave të punës të cilat shkojnë në drejtim të zbatimit të kësaj strategjie; krijimi i koordinimit efikas dhe efektiv të brendshëm dhe ndërsektorial dhe krijimin e procedurave formale të hollësishme për të gjitha shërbimet sociale të cilat i ofron komuna.

- **SSH2:** Realizimi i partneriteteve të suksesshme me sektorin publik, privat dhe civil

Shpërndarja bashkëkohore e shërbimeve sociale është e paimagjinueshme pa krijimin e partneriteteve për këtë qëllim, ndërsa SWOT-analiza e bërë gjatë përpilimit të strategjisë tregoi se në mjediset rreth komunës ka mundësi për partneritet, biznes aktiv dhe sektorë civil, e nga ana tjetër është përfshirë sistem tek vet komuna.

Në këtë drejtim, masat do të përfshijnë: mekanizma për koordinim dhe bashkëpunim me sektorin publik, privat dhe civil dhe formimin e Bazës për të dhënat e shoqatave aktive të qytetarëve me interes publik, dhe partnerëve potencial nga sektori publik dhe privat.

- **SSh3:** Organizimi i ofrimit institucional dhe jashtë insitucional i shërbimeve

Vizioni i Komunës së Strugës përfshinë mbrojtje të fuqishme të qytetarëve të interesuar, që në vete përfshin shërbime konkrete, gjegjësisht, mbrojtje edhe institucionale edhe jashtë institucionale. Që të realizohet ky prioritet është i nevojshëm vlerësimi i nevojave për institucione të reja në suazat e fushave për: mbrojtje të fëmijëve, mbrojtje jashtë institucionale të personave të moshuar, fëmijë, mbështetje personave me nevoja të veçanta, ndihmë materiale, mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve, e pastaj edhe ndërtimi i procedurave për formimin dhe menaxhimin me institucionet lokale, si edhe Rritja e numrit të institucioneve lokale.

7.4 Qytetarë të kënaqur

Qëllimi strategjik prioritar i identifikuar në perspektivën “qytetarë të kënaqur” duhet të mundësojë arritjen e vizionit dhe realizimin e pritjeve të qytetarëve të interesuar për mbrojtje sociale nga ana e Komunës së Strugës. Nga ky aspekt, e duke marrë parasysh të gjitha analizat e bëra në fazën përgatitore, është përcaktuar një prioritet:

- **QK1:** Sigurimi i mbrojtjes sociale për qytetarët në mënyrë të lehtë, efikase dhe transparente përmes vëllimit të rritur të shërbimeve

Ky prioritet është shumë kompleks dhe nuk është i thjeshtë për arritje, para së gjithash për shkak se komuna nuk ka njohuri shumë të mira të grupeve të qytetarëve të interesuar, duke pasur

parasysh se bëhet fjalë për një kompetencë të re. Prandaj masa e parë në rrugën drejt realizimit të këtij kapaciteti është identifikimi i grupit të qytetarëve të rrezikuar, e pastaj mbi bazë të grupeve të interesuara të qytetarëve të bëhet përcaktimi i listës për shërbime sociale, e pastaj, në drejtim të forcimit të transparencës edhe komunikimi publik i procedurave për marrjen e shërbimit social. Këtu fillon edhe kujdesi për shfrytëzuesit, prandaj masat e propozuara në vijim janë krijimi i sistemit për Kujdes për shfrytëzuesit e shërbimeve sociale dhe Planifikimi i rritjes së vëllimit të shërbimeve sociale me kalimin e kohës, e në pajtueshmëri me nevojat e shfrytëzuesve dhe popullatës.

HARTA E BALANCUAR E TREGUESVE TË KOMUNËS SË STRUGËS PËR SFERËN E MBROJTJES SOCIALE

Harta e balancuar e treguesve mundëson që të ndiqen më së miri hapat strategjike të cilat do t'i ndërmarrë Komuna e Strugës në periudhën e viteve 2015-2020 dhe cilat rezultate duhet t'i arrijë që të realizojë vizionin e vet për bashkëpunim me sektorin civil në komunë, siç është paraqitur në tabelën e poshtme. Me qëllim që të sigurohet fokus më i mirë strategjik dhe prioritet në implementimin e aktiviteteve, deri te secili nga katër aspektet e strategjisë dhe tek prioritetet strategjike, në kllapa është dhënë domethënia (rëndësia) relative për secilin nga aspektet dhe prioritetet përkatëse strategjike të shprehura në përqindje. Shuma në përqindje tregon rëndësinë e secilit aspekt në raport me tre aspektet tjera, si dhe rëndësinë e secilit prioritet strategjik në kuadër të katër aspekteve. Përqindja më e madhe tregon fokus strategjik dhe rëndësi më të madhe të atij aspekti ose prioriteti.

Harta e balancuar e treguesve të Komunës së Strugës për sferën e mbrojtjes sociale

HARTA E BALANCUAR E TREGUESVE TË KOMUNËS SË STRUGËS MBI POLITIKAT LOKALE PËR MBROJTJE SOCIALE TË QYTETARËVE 2015-2020

VIZIONI:

„Grupet e rrezikuara të qytetarëve janë përfshirë në jetën e përditshme të komunës nëpërmjet institucioneve të organizuara për mbështetjen e tyre dhe kushteve të krijuara për ekzistencë të pavarur materiale“

Prioritetet	Treguesit	Vlerat qëllimore 2020	Masat/Iniciativat
Perspektiva – QYTETARË TË KËNAQUR (15%)			
QK1: Sigurimi i mbrojtjes sociale për qytetarët në mënyrë të lehtë, efikase dhe transparente, përmes rritjes së vëllimit të kapaciteteve. (15%)	1.1 Përqindja e qytetarëve të prekur të cilët konsiderojnë se kanë pranuar shërbim në mënyrë efikase edhe transparente	55%	<p>1.1 Njohja e grupit të qytetarëve të prekshëm</p> <p>1.2 Definimi i listës të shërbimeve sociale</p> <p>1.3 Komunikim publik të procedurave për pranimin e shërbimeve sociale</p> <p>1.4 Kujdesi për shfrytëzuesit e shërbimeve sociale</p> <p>1.5 Planifikimi i rritjes së vëllimit të shërbimeve sociale</p>

**HARTA E BALANCUAR E TREGUESVE TË KOMUNËS SË STRUGËS MBI POLITIKAT
LOKALE PËR MBROJTJE SOCIALE TË QYTETARËVE 2015-2020**

VIZIONI:

„Grupet e rrezikuara të qytetarëve janë përfshirë në jetën e përditshme të komunës nëpërmjet institucioneve të organizuara për mbështetjen e tyre dhe kushteve të krijuara për ekzistencë të pavarur materiale“

Prioritetet	Treguesit	Vlerat qëllimore 2020	Masat/Iniciativat
Perspektiva – SIGURIMI I SHËRBIMEVE (27%)			
SSH1: Ndërtimi i sektorit kompakt, funksional dhe i integruar për mbrojtje sociale(12%)	1.1 Numri i shërbimeve për të cilat janë përpiluar procedura të detajizuara	15	1.1 Analiza e kompetencave dhe sistematizimi i sektorit 1.2 Vendosija e koordinimit efikas dhe efektiv intern dhe ndërsektorial. 1.3 Vendosija e procedurave detale për të gjitha shërbimet sociale të cilat i ofron komuna
SSH2: Realizimi i partneriteteve të suksesshme me sektorin publik, privat dhe civil. (7%)	2.1 Numri i mekanizmave të implementuar për koordinim me institucionet tjera	5	2.1 Mekanizma për koordinim dhe bashkëpunim me sektorin publik, privat dhe civil. 2.2 Bazë e të dhënave e shoqatave aktive qytetare me interes publik, partner potencial nga sektori publik dhe privat
SSH3: Organizimi institucional dhe jashtë insitucional i shërbimeve(6%)	3.1 Numri i institucioneve lokale	3	3.1 Vlerësim i nevojave për institucione të reja në suazat e sferave për: mbrojtjen e fëmijëve, mbrojtje jashtë institucionale për personat e moshuar, fëmijë, mbështetje për personat me nevoja të veçanta, ndihmë materiale, mbrojtje të shëndetit të qytetarëve. 3.2 Ndërtimi i procedurave për formimin dhe menaxhimin e institucioneve lokale përmes krijimit të partneriteteve 3.3 Rritja e numrit të institucioneve lokale

Harta e balancuar e treguesve të Komunës së Strugës për sferën e mbrojtjes sociale

HARTA E BALANCUAR E TREGUESVE TË KOMUNËS SË STRUGËS MBI POLITIKAT LOKALE PËR MBROJTJE SOCIALE TË QYTETARËVE 2015-2020

VIZIONI:

„Grupet e rrezikuara të qytetarëve janë përfshirë në jetën e përditshme të komunës nëpërmjet institucioneve të organizuara për mbështetjen e tyre dhe kushteve të krijuara për ekzistencë të pavarur materiale“

Prioritetet	Treguesit	Vlerat qëllimore 2020	Masat/Iniciativat
Perspektiva – ZHVILLIMI I KAPACITETEVE (21%)			
ZHK1: Avancim i sistemit për zhvillimin e resurseve njerëzore përshkak të përfitimit të aftësive, kapaciteteve dhe resurseve për zbatimin me sukses të aktiviteteve (13%)	1.1 Numri i trajnimeve gjatë vitit	2	<p>1.1 Trajnimi i rregullt dhe sistematik të punësuarve në sektor</p> <p>1.2 Vendosja e kulturës për bashkëpunim intern, ndërsektorial dhe ndërinstucionale</p> <p>1.3 Vendosja e kapaciteteve për këmbim të njohurive dhe përvojave me partnerët dhe faktorët tjerë</p>
ZHK2: Futja e sistemit vullnetar (shërbimi) është kapacitet plotësues në zbatimin e kompetencave(7%)	2.1 Numri i aktiviteteve me shërbim të përfshirë vullnetar	10	<p>2.1 Planifikimi i rolit të sistemit vullnetar në zbatimin e mbrojtjes sociale në nivel lokal</p> <p>2.2 Krijimi i shërbimit vullnetar dhe implementimit</p>

HARTA E BALANCUAR E TREGUESVE TË KOMUNËS SË STRUGËS MBI POLITIKAT LOKALE PËR MBROJTJE SOCIALE TË QYTETARËVE 2015-2020

VIZIONI:

„Grupet e rrezikuara të qytetarëve janë përfshirë në jetën e përditshme të komunës nëpërmjet institucioneve të organizuara për mbështetjen e tyre dhe kushteve të krijuara për ekzistencë të pavarur materiale“

Prioritetet	Treguesit	Vlerat qëllimore 2020	Masat/Iniciativat
Perspektiva – MENAXHIMI ME BUXHETIN (37%)			
MB1: Arritja e vëllimit të lartë të burimeve të jashtme të mjeteve për mbrojtje sociale(8%)	1.1 lartësia e mjeteve të jashtme për mbrojtje sociale në raport me sasin e përgjithshme të mjeteve	50%	1.1 Zbatimi i sistemit/politikës për ko-financim të projekteve dhe aktiviteteve me sektorin e biznesit dhe joqeveritar (PPP) 1.2 Shfrytëzimi i fondeve të BE 1.3 Zbatimi i politikës stimuluese tatimore për partneritetet dhe aktivitetet në mbrojtjen sociale
MB2: Arritje e konsistencës në mjetet buxhetore për mbrojtje sociale(17%)	2.1 Përqindja e buxhetit themelor komunal i dedikuar për mbrojtjen sociale	1,5%	2.1 Metodologjia për shpërndarjen e brendshme të buxhetit komunal, lidhur me programin për mbrojtje sociale
MB3: Rritja e investimeve për mbrojtje sociale (12%)	3.1 Numri i programeve zhvillimore për mbrojtje sociale	5	3.1 Përkufizimi i projektit nga sfera e mbrojtjes sociale në pjesën zhvillimore të buxhetit 3.1 Dizanjimi i ideve projektuese për tërheqjen e financave 3.3 Aplikim për thirrje publike për grante

VLERAT:

INOVACION, PROFESIONALIZËM, PRIORITET TË GRUPEVE TË RREZIKUARA, LIGJSHMËRI, ETIKË, PARTNERITET I KOMUNËS ME INSTITUCIONET PUBLIKE, OJQ DHE SEKTORI I BIZNESIT, BARAZI- TRAJTIM I BARABARTË MULTIETNIK DHE FETAR, PËRFSHIRJE, TRANSPARENÇË

MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Harta e Balancuar e treguesve paraqet mjet të rëndësishëm për monitorimin e implementimit të kësaj strategjie, duke i pasur parasysh të gjitha qëllimet dhe masat - financiare dhe jofinanciare - që rrjedhin nga vizioni. Realizimi i përfitimeve të komunës nga HBT-ja ndiqet nëpërmjet raporteve, diskutimeve, komunikimit, azhurnimit dhe veprimit. Raportet e komunës të HBT-së përgatiten çdo tre muaj, sipas një rendi të caktuar. Në procesin e monitorimit kanë rol kryetari i komunës, sekretari dhe udhëheqësit e sektorëve të cilët janë përgjegjës për implementimin e masave dhe aktiviteteve për objektivat përkatëse prioritare strategjike.

Roli i Kryetarit të komunës emëron person i cili do të jetë përgjegjës për monitorimin e implementimit të Strategjisë për Mbrojtje Sociale të Qytetarëve të Komunës së Strugës. Personi përgjegjës për monitorimin e implementimit të strategjisë i kryen aktivitetet vijuese:

- e koordinon mbledhjen e informatave nga sektorët;
- i informon udhëheqësit e sektorëve për afatet përfundimtare për dorëzimin e raporteve sektoriale;
- i konsolidon raportet sektoriale në Raport të vetëm HBT të Komunës së Strugës për bashkëpunim me sektorin civil ;
- i dorëzon raportet e konsoliduara te sekretari, Kryetari i komunës dhe Këshilltarët e Komunës së Strugës, dhe
- e monitoron dhe e zbaton procesin e përfshirjes së ndryshimeve në HBT.

Në kuadër të procesit për ndjekjen e arritjes së vlerave të synuara nga HBT për mbrojtje sociale të qytetarëve të Komunës së Strugës, udhëheqësit e sektorëve i kanë detyrat në vijim:

- të caktojnë person përgjegjës për secilin tregues të prioriteteve strategjike të cilat janë pjesë e qëllimeve të sektorit;
- të përgatisin raport për zbatimin e aktiviteteve në nivel të sektorit;
- të marrin pjesë në rishikimin e treguesve për secilin qëllim prioritar i cili është pjesë e qëllimeve të sektorit.

Personi përgjegjës për secilin tregues nga qëllimet strategjike prioritare në procesin e monitorimit të arritjes së vlerave të synuara nga HBT i kryen aktivitetet në vijim:

- e koordinon mbledhjen e informatave në kuadër të sektorit;
- e informon udhëheqësin e sektorit për afatet përfundimtare për dorëzimin e raportit sektorial;
- e përpunon raportin e vetëm sektorial dhe e dorëzon te udhëheqësi i sektorit;
- e monitoron dhe e zbaton procesin e përfshirjes së ndryshimeve në HBT.

Përveç monitorimit, HBT-ja do të shfrytëzohet për vlerësimin e zbatimit të planit strategjik, me qëllim të vërtetohet se a janë arritur qëllimet e planifikuara në mënyrë efikase dhe se a janë paraqitur efekte të padëshirueshme dhe deri në cilën shkallë janë ato.

Prishja apo ndërprerja e lidhjes shkak-pasojë të prioriteteve, si edhe mos arritja e vlerave të qëllimit të treguesve për prioritetet e veçanta do të japë informacione mbi atë se a duhet dhe çfarë ndryshimesh duhet bërë në kornizat e Planit Strategjik.

